

PROCESVERBAL

Mbahet sot, në datë 04.07.2019, për takimin e organizuar në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, të iniciuar nga shoqatat e kineastëve, ku morën pjesë kryetarë të disa prej shoqatave të kineastëve:

1. Z. Ndriçim Xhepa
2. Z. Pluton Vasi
3. Znj. Sabina Kodra
4. Z. Dritan Huqi
5. Z. Jonid Jorgji

Qendra Kombëtare e Kinematografisë përfaqësohej nga:

1. Z. Eduart Makri, Kryetar;
2. Z. Arben Lami, Drejtor i Drejtorisë së Projekteve;
3. Znj. Shqiponja Dauti, Juriste.

Në takim u diskutuan çështje që shqetësojnë komunitetin e kineastëve dhe kryesisht emergjenca për zhbllokimin e situatës për shkak të mundësisë së rialokimit të buxhetit të shtetit dhe u ra dakort sa më poshtë:

1. Të organizohet një takim me rend dite të përcaktuar, për diskutimin e problematikave të komunitetit, ku të thirren dhe të marrin pjesë të gjithë kryetarët e shoqatave të kineastëve.
2. Rendi i ditës së mbledhjes/ve të ardhshme do të përcaktohet paraprakisht dhe palët do të diskutojnë mbi dokumenta/objeksione të depozituara paraprakisht në zyrën e protokollit të QKK. Nuk do të pranohen diskutime për tematika nuk janë përcaktuar për rendin e ditës.
3. Mbledhjet që do të zhvillohen në vijimësi, për transparencë do të bëhen me regjistrim zanor.
4. Kryetarët e shoqatave të kineastëve do të jenë pjesë e një Këshilli Konsultativ pranë Kryetarit të QKK, që do të funksionojë sistematikisht në proceset vendimmarrëse për ndryshimet që do të bëhen në aktet ligjore.
5. Të rishikohen kriteret e anëtarëve me shtetësi shqiptare pjesëmarrës në Këshillat e Miratimit të Projekteve. Të përzgjidhen kandidaturat më të mira nga aplikuesit.
6. Pas mbylljes së procesit të aplikimit, shoqatat e kineastëve të përzgjedhin 3 (tre) kandidatura me shtetësi të huaj, për të qenë pjesë e KMP, sipas dakordësisë së mbledhjes së datës 30.05.2019.
7. Pas mbylljes së procesit të aplikimit, shoqatat e kineastëve të përzgjedhin 5 (pesë) kandidatura me shtetësi shqiptare për të qenë pjesë e Këshillit të Miratimit të Projekteve. Anëtarët me shtetësi shqiptare, do të miratohen si anëtarë të Këshillit të Miratimit të Projekteve, pasi të japin dorëheqje zyrtare

me shkrim nga shoqata e kineastëve ku bëjnë pjesë (në rast se janë anëtarë në një shoqatë).

8. Këshilli i Miratimit të Projekteve i ngritur sipas përcaktimit të bërë në pikën 6 të këtij procesverballi, do të ketë mandat ligjor deri në miratimin e ndryshimeve përkatëse në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 31.10.2018, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve, ose komisioneve të qeverisjes qendrore". Më pas tre anëtarë të KMP me shtetësi shqiptare do të japin dorëheqje të parevokushme nga detyra e tyre.

9. Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të KMP të përfundojë brenda datës 20.07.2019.

10. Sa u diskutua dhe dakordësua në këtë takim, kryetarët e shoqatave prezentë ranë dakord që të vënë në dijeni dhe të marrin miratim edhe kryetarët e shoqatave që nuk ishin present në këtë takim. Gjithë procedura dhe komunikimi ndërmjet shoqatave do të bëhet me shkrim, zyrtarisht.

11. Shoqatat e kineastëve që kanë vullnetin për të qenë pjesë e procesit të vendimmarrjes për përzgjedhjen e KMP të sjellin propozimet e tyre me shkrim për zgjidhjen e situatës së emergjencës.

Procesverballi nënshkruhet pa vërejtje në 2 (dy) kopje origjinale.

Ndriçim Xhepa

Dritan Huqi

Sabina Kodra

Pluton Vasi

Jonid Jorgji

Eduart Makri

Arben Lami

Shqiponja Dauti